

LIGJ
NR.9634, datë 30.10.2006

PËR INSPEKTIMIN E PUNËS

(ndryshuar me ligjet nr. 24/2013, datë 14.2.2013 dhe nr. 57/2017, datë 20.4.2017; nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë, nëpërmjet strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës, zbatimin e legjislacionit të punës nga subjektet, mbi të cilat vepron ky ligj, në përputhje me procedurat e kryerjes së inspektimit në punë.

Neni 2
Përkufizime

(ndryshuar pika 1, 2, 6 dhe shfuqizuar pikat 16, 17, 18, me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013, ndryshuar me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Inspektorat” është struktura përgjegjëse për inspektimin e punës, organizimi dhe funksionimi i të cilit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

2. “Inspektim në punë” është çdo formë kontrolli për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, sipas legjislacionit të punës, i bërë nga inspektorati, në përputhje me këtë ligj dhe me ligjin për inspektimin.

3. “Legjislacion i punës” janë:

- a) konventat e ratifikuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;
- b) ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- c) ligji nr. 10 237, datë 18.2.2010, “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, i ndryshuar;
- ç) ligji nr. 7995, datë 20.9.1995, “Për nxitjen e punësimit”, i ndryshuar;
- d) ligji nr. 9136, datë 11.9.2003, “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

dh) ligji nr. 108/2013, “Për të huajt”, i ndryshuar;

e) i gjithë legjislacioni që ngarkon Inspektoratin e Punës për sigurimin e zbatueshmërisë së tyre;

ë) aktet nënligjore në zbatim të shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d” dhe “dh”, të pikës 3, të këtij neni.”.

4. “Ministër” është ministri, i cili mbulon çështjet që kanë të bëjnë me legjislacionin e punës.

5. “Person fizik”, “Person juridik” apo “Subjekt” është çdo person fizik apo juridik, sipas përcaktimit të bërë në Kodin Civil.

6. “Inspektor pune” është trupa inspektuese e strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës.
7. “Mirëqenie në punë” janë të gjitha lehtësitë sociale që duhet t’u krijojë punëdhënësi punëmarrësve, si: shërbimi i ushqimit, shërbimi i shëndetit në punë, shërbimi i kohës së lirë, shërbimi i transportit të punëmarrësve, si dhe shërbimi i personelit.
8. “Kushte pune” janë elementet që lidhen me mjedisin, në të cilin një punëmarrës ushtron veprimtarinë e vet, si dhe elementet sociale e administrative, të tilla si pagat, kohëzgjatja e punës, puna e natës, pushimi javor dhe ai vjetor.
9. “Degë e veprimtarisë ekonomike” është çdo degë, ku punësohet punëmarrësi, përfshirë dhe shërbimin publik.
10. “Punësim informal” është një marrëdhënie punësimi që nuk u nënshtrohet, si nga ana ligjore, ashtu edhe në praktikë, kërkesave të legjislacionit të punës dhe ligjit për procedurat tatimore dhe ku punëmarrësi nuk përfiton të drejtat e tij, që burojnë nga këto ligje.
11. “Aksesueshmëri e personave me aftësi të kufizuara” është mënjanimi i pengesave sociale, mjedisore dhe infrastrukturore për të bërë të mundur aksesin në vendin e punës.

Neni 3

Fusha e zbatimit dhe shtrirja në hapësirë

Ky ligj zbatohet mbi personat fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, privatë ose publikë, që ushtrojnë veprimtari ekonomike fitimprurëse apo jofitimprurëse në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Përfshirja

1. Përfshihen nga fusha e zbatimit të këtij ligji:
 - a) institucionet apo veprimtaritë, ku hyrja e trupës inspektuese të punës vë në rrezik interesin e sigurisë kombëtare;
 - b) të gjitha vendet e punës, ku inspektimi për marrëdhëniet e punës, sigurinë dhe shëndetin në punë janë të rregulluara me ligje të veçanta.
2. Për rastet e veçanta, me përfshirje të rasteve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 1 të këtij neni, trupa inspektuese e punës duhet të pajisen me autorizim nga institucionet përkatëse.

KREU II

SISTEMI I INSPEKTIMIT TË PUNËS

Neni 5

Politikat shtetërore të inspektimit në punë

1. Shteti përcakton, për të gjitha vendet e punës, një sistem të inspektimit në punë, në bazë të të cilit kërkohet zbatimi i dispozitave të legjislacionit të punës, kontratës kolektive dhe mbrojtjes gjatë procesit të punës të punëmarrësve dhe që sigurohet nga trupa inspektuese.
2. Ministri harton politika dhe merr masa, që synojnë zbatimin e tyre nëpërmjet:
 - a) zbatimit të dispozitave të legjislacionit të punës në të gjitha vendet e punës;
 - b) nxitjes së masave të sigurimit në vendet e punës, ku përdoren substanca të rrezikshme;
 - c) fuqizimit të masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale.

Neni 6

Misioni i strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës

1. Misioni i përgjithshëm i strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës është kontrolli, konstatimi, këshillimi, njoftimi, formimi, zbutja e konflikteve, parandalimi dhe sanksionimi.

2. Struktura përgjegjëse për inspektimin e punës ngarkohet:

a) të sigurojë zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që trupa inspektuese e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave;

b) t'u japë të dhëna dhe këshilla teknike punëdhënësit dhe punëmarrësit për mjetet më efikase të shqyrtimit të dispozitave ligjore;

c) të vërë në dijeni autoritetin përgjegjës për mangësitë dhe abuzimet, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat ligjore në fuqi, si dhe të propozojë mjetet dhe instrumentet e nevojshme për përmirësimin e gjendjes.

Neni 7

Autoriteti dhe kompetencat e ministrit

(shfuqizuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

Neni 8

Organizimi dhe drejtimi i strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës

(shfuqizuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

Neni 9

Autoriteti i Kryeinspektorit të strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës

(shfuqizuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

Neni 10

Kompetencat dhe detyrat e Kryeinspektorit të strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës

(shfuqizuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

Neni 11

Kompetencat dhe detyrat e drejtorit të drejtorisë rajonale

(shfuqizuar pika 7 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Drejtori i drejtorisë rajonale ka këto detyra:

1. Përfaqëson dhe drejton veprimtarinë e drejtorisë rajonale të inspektimit të punës.
2. Përcakton objektivat e punës, që dalin nga përparësitë e inspektimit.
3. Raporton tek Kryeinspektori i strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës sa herë që i kërkohet.

4. Raporton, brenda javës së parë të muajit pasardhës, për të gjithë treguesit e inspektimit të realizuar, sipas programit të miratuar nga Kryeinspektori i strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës.

5. Ushtron kontroll për vlerësimin e efektivitetit të punës së trupës inspektuese.

6. Harton raportin vjetor të veprimtarisë së drejtorisë rajonale, të cilin ia paraqet Kryeinspektorit të strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës.

7. Shfuqizuar.

Neni 12

Bashkëpunimi me institucionet e tjera

1. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë, struktura përgjegjëse për inspektimin e punës siguron bashkëpunimin me:
ministritë dhe institucionet në varësi të tyre, si dhe me institucione të tjera shtetërore;
punëmarrësit dhe me punëdhënësit, si dhe me organizatat e tyre;
shërbime private, që kryejnë veprimtari të ngjashme.
2. Bashkëpunimi me subjektet e sipërpërmendura rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU III

KOMPETENCAT DHE DETYRAT E TRUPËS INSPEKTUESE

Neni 13

Kompetencat e përgjithshme të trupës inspektuese

(shtuar një fjali në pikën 1 dhe hequr fjalë me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013; shfuqizuar pika 6 me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

1. Trupa inspektuese është e autorizuar të hyjë në mjediset e punës së çdo subjekti, me përjashtim të mjediseve të banimit, pa bërë njoftim paraprak, në çdo orë të ditës ose të natës, në të gjitha subjektet, filialet, kantieret, që i nënshtrohen inspektimit. Në rast të kryerjes së inspektimit pa njoftim paraprak, trupa inspektuese është e detyruar të respektojë edhe kërkesat e ligjit për inspektimin.

2. Trupa inspektuese, për të kontrolluar zbatimin e dispozitave të legjislacionit të punës, në mjediset që shërbejnë për banim, autorizohet të hyjë nëse ka tregues të mjaftueshëm apo motive ligjore, të cilat e prezumojnë këtë.

Për kryerjen e këtij kontrolli, trupa inspektuese detyrohet të njoftojë Inspektorin e Përgjithshëm për vazhdimin e procedurave të mëtejshme ligjore për inspektim.

3. Me fillimin e ushtrimit të kontrollit, të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, trupa inspektuese është e detyruar të njoftojnë për praninë e tyre punëdhënësin apo përfaqësuesin e tij, si dhe përfaqësuesin e sindikatës, nëse ekziston një e tillë, ose përfaqësuesin e punëmarrësve.

Kur trupa inspektuese gjkon se shoqërimi ose prania e punëdhënësit ose e përfaqësuesit të tij përbën pengesë për kryerjen e detyrës, ai kryen inspektimin pa praninë e tyre.

4. Trupa inspektuese, gjatë inspektimit, është e autorizuar:

- a) të kërkojë të dhënat e nevojshme për personat e pranishëm në vendet e punës dhe të provojnë identitetin, duke kërkuar prova identifikimi;
- b) të kontrollojë pagesën e kontributeve të sigurimeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore për të gjithë të punësuarit në vendin e punës;
- c) të kryejë inspektimin e vendeve të punës aq herë dhe në atë masë sa është e nevojshme për të siguruar zbatimin efektiv të dispozitave të legjislacionit të punës në fuqi.

5. Trupa inspektuese e punës ka për detyrë të njoftojë autoritetin përgjegjës për parregullsitë, që nuk mbulohen në mënyrë të veçantë nga dispozitat e legjislacionit të punës.

6. Shfuqizuar.

Neni 14

Kompetencat e veçanta të trupës inspektuese

(ndryshuar pika 4 me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013; shtuar fjalë në pikën 7 dhe shfuqizuar pika 9 me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Për të siguruar zbatimin e dispozitave ligjore, nënligjore dhe administrative, trupa

inspektuese është e autorizuar:

1. Të kryejë ekzaminime, kontrolle dhe hetime në mjediset e punës.
2. Të intervistojë punëmarrësit vetëm ose në praninë e punëdhënësit apo të përfaqësuesit të tij për kushtet e punës.
3. Të dokumentojë të gjitha shkeljet e vëna re gjatë inspektimit nëpërmjet fotografimit, regjistrimeve audio dhe video.
4. Të verifikojë regjistrat apo dokumentet e tjera dhe të bëjnë kopjet e tyre, kur e shohin të arsyeshme. Marrja e kopjeve, sekuestrimi i dokumenteve dhe trajtimi i informacionit, që pasqyrohet në to, bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.
5. Të kërkojë vendosjen e sinjalistikës së nevojshme sipas proceseve të punës.
6. Të urdhërojë punëdhënësin të njoftojë punëmarrësit nëpërmjet afishimit dhe/ose nëpërmjet një mjeti tjetër komunikimi të përshtatshëm për:
 - a) vendimet e marra nga trupa inspektuese e punës për ndërmarrjen;
 - b) udhëzimet apo rregulloret mbi të drejtën e punës, sigurinë dhe shëndetin e punëmarrësve;
 - c) instruktimin teknik të sigurisë, të shprehur me fjalë apo të shprehur në mënyrë grafike.
7. Të marrin apo të nxjerrin, për qëllime analizash, mostra të lëndëve dhe substancave, që përdoren gjatë procesit të punës në përputhje me ligjin për inspektimin. Në çdo rast duhet që punëdhënësi apo përfaqësuesi i tij të jetë në dijeni për qëllimin e marrjes së tyre.
8. Të kërkojnë nga punëdhënësi kryerjen e matjeve teknike, me qëllim respektimin e standardeve, për sa i përket shëndetit dhe sigurisë së punëmarrësve, në rastet kur një gjë e tillë është e motivuar në mënyrë të ndjeshme.
9. Shfuqizuar.

Neni 15

Mjetet e ndërhyrjes në rastin e shkeljeve të legjislacionit të punës

(ndryshuar fjalë me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Trupa inspektuese, me qëllim përmirësimin e gjendjes dhe shmangien e shkeljeve të dispozitave ligjore, të cilat i janë ngarkuar për zbatim strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës, procedon administrativisht, në përputhje me ligjin për inspektimin:

1. Për respektimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës e të punësimit për detyrimin e punëdhënësit:
 - a) për të përfunduar me shkrim kontratën individuale të punës, për ata punëmarrës që nuk e kanë një dokument të tillë në çastin e kontrollit, dhe kontratën kolektive;
 - b) për korrigjimin e atyre neneve të kontratës individuale, të cilat parashikojnë kushte më të disfavorshme se ato të parashikuara në legjislacionin dhe kontratën kolektive të punës;
 - c) për të paraqitur dokumentin e degës përkatëse të tatimeve për deklarimin dhe pagesën e kontributeve për sigurimet e detyrueshme shoqërore e shëndetësore për të gjithë punëmarrësit;
 - ç) për të respektuar punësimin e personave me aftësi të kufizuara, sipas legjislacionit në fuqi;
 - d) për të respektuar punësimin dhe mbrojtjen e fëmijëve, grave shtatzëna dhe nënave të reja;
 - dh) për detyrimet e parashikuara në ligj për kohëzgjatjen e punës dhe të pushimit;
 - e) për detyrimet ligjore për punën e natës;
 - ë) për të respektuar pajisjen me leje pune për punëmarrësit e huaj, në përputhje me ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”;
 - f) për respektimin e pagës minimale, të miratuar nga Këshilli i Ministrave;
 - g) për të paraqitur dokumentet e deklarimit të punëmarrësve të punësuar dhe të larguar rishtazi, në përputhje me legjislacionin në fuqi;
 - gj) për respektimin e lirive dhe të drejtave sindikale.
2. Për respektimin e dispozitave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve

për detyrimin e punëdhënësit:

- a) për marrjen e lejes nga trupa inspektuese e punës para vënies në punë të ndërmarrjes ose të një pjese të saj, në përputhje me Kodin e Punës;
- b) për riparimin e defekteve që vërehen gjatë funksionimit të pajisjeve apo përdorimit të metodave të punës, për të cilat trupa inspektuese vlerëson se ka shkaqe të arsyeshme dhe se ato përbëjnë një kërcënim për shëndetin apo sigurinë e punëmarrësve;
- c) për kryerjen e kontrolleve teknike të instalimeve të aparaturave e të makinerive;
- ç) për modifikimin e instalimeve të nevojshme brenda një afati të caktuar kohor;
- d) për aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar në vendin e punës, sipas ligjit nr. 93/2014, “Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuar”, dhe akteve nënligjore të tij.

Ministri përgjegjës për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë nxjerr udhëzimin për detyrimet që kanë subjektet publike dhe private për zbatimin e kësaj shkronje.

Neni 16

Mbrojtja e kontrollit të punës

(ndryshuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013 dhe shfuqizuar me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Neni 17

Shmangia e konfliktit të interesave

1. Trupa inspektuese është e ndaluar të kontrollojë subjektet, që u përkasin të afërmeve të tyre deri në shkallën e dytë, si dhe nuk mund të përfshihet në këto kontrolle në rastet kur ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, konflikt interesi ose mosmarrëveshje vetjake ndërmjet tyre dhe subjektit që do të kontrollohet.

2. Në çdo rast, kur ekziston një marrëdhënie e drejtpërdrejtë apo e tërthortë, konflikt interesi ose mosmarrëveshje vetjake ndërmjet subjektit që do të kontrollohet dhe trupës inspektuese, këta të fundit bëjnë një deklaratë pranë eprorit direkt.

3. Nëpunësit e nivelit qendror, rajonal dhe vendor, trupa inspektuese nuk lejohet të ushtrojnë veprimtari private, si dhe të jetë e punësuar në sektorin privat.

Neni 18

Moszbatimi i ligjit nga trupa inspektuese

(zëvendësuar fjalë në pikën 1 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Në rastet kur trupa inspektuese, gjatë ushtrimit të detyrës, shkel nenet 13, 14, 15, 16, 17, 19, 20, 26, 27, 30, 31, 32, 33, 35 dhe 37 të këtij ligji, zbatohen procedurat dhe masat disiplinore, të parashikuara në ligjin për inspektimin.

2. Në rastet kur shkelja përbën vepër penale, zbatohen dispozitat e Kodit Penal.

Neni 19

(ndryshuar me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Trupa inspektuese e punës duhet të respektojë Kodin e Etikës për punonjësit e inspektorateve shtetërore në Republikën e Shqipërisë.

Neni 20
Ruajtja e konfidencialitetit

Trupa inspektuese duhet të ruajë konfidencialitetin e të dhënave përkatëse, që ata mund të kenë për subjektet ku kanë ushtruar kontroll për një periudhë trevjeçare pas largimit nga detyra.

KREU IV
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PUNËDHËNËSVE DHE TË PUNËMARRËSVE

Neni 21
Të drejtat e punëdhënësit

Punëdhënësi ka të drejtë:

- a) të marrë nga Inspektorati të gjitha të dhënat e kërkuara në lidhje me legjislacionin e punës;
- b) të kërkojë, me shkrim, mendimin e Inspektoratit për çdo çështje ose problem të veçantë, që lidhet me zbatimin e legjislacionit të punës.

Neni 22
Detyrimet e punëdhënësit
(shfuqizuar pika 4 dhe ndryshuar pika 5 me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

1. Punëdhënësi duhet të njoftojë menjëherë Inspektoratin për të gjitha aksidentet në punë, që shoqërohen me vdekje ose jo, si dhe për sëmundjet profesionale.
2. Punëdhënësi duhet të sigurojë të gjitha të dhënat e nevojshme, që lidhen me zbatimin e legjislacionit të punës, kur e kërkon trupa inspektuese.
3. Punëdhënësi ka për detyrë të raportojë tek trupa inspektuese për rezultatet e kontrollit teknik që ai kryen në instalimet, aparaturat dhe makineritë që zotëron.
4. Shfuqizuar.
5. Punëdhënësi duhet të marrë leje nga Inspektorati i Punës para vënies në punë të ndërmarrjes apo të një pjese të saj, si dhe për çdo ndryshim teknologjie prodhimi, për mënyrën e organizimit të punës, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Punëdhënësi ose përfaqësuesi i tij është i detyruar të paraqitet në zyrën e trupës inspektuese të punës pas marrjes së njoftimit të bërë nga trupa inspektuese e punës në ndërmarrjen e tij.

Neni 23
Bashkëpunimi i punëdhënësit me punëmarrësit

Punëdhënësi duhet të bashkëpunojë me punëmarrësit ose me organizatën sindikale të punëmarrësve, në rastet kur ekziston një e tillë, me qëllim përmirësimin e kushteve që ndikojnë në shëndetin dhe sigurinë në punë.

Neni 24
E drejta e punëmarrësit

Punëmarrësi apo organizata sindikale e punëmarrësve, nëse ka një të tillë, ku ai bën pjesë, ka të drejtë të ankohet, me shkrim apo me gojë, pranë Inspektoratit, nëse punëdhënësi shkel një dispozitë të legjislacionit të punës.

Inspektorati, në rastet e kontrollit në vijim të një ankese, duhet të trajtojë tërësisht

konfidencial burimin e çdo ankimi, si në rastet e depozitimit me shkrim pranë Inspektoratit, ashtu dhe në rastet e procedimit gjatë vizitës së inspektimit.

Neni 25

Detyrimet e punëmarrësit

(ndryshuar me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Punëmarrësi respekton urdhrat dhe udhëzimet e punëdhënësit për masat e sigurisë e të shëndetit në punë, përdor të gjitha pajisjet e punës dhe mjetet mbrojtëse individuale, si dhe merr pjesë aktive në formim, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU V

DETYRIMI I INSPEKTORATIT PËR INFORMIM DHE KËSHILLIM

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Neni 26

Informimi dhe këshillimi

(ndryshuar titulli me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

Inspektorati këshillon dhe instrukton punëdhënësit dhe punëmarrësit për legjislacionin e punës dhe për çështjet që lidhen me sigurimin në punë nëpërmjet:

a) leksioneve, bisedave në media, posterave, fletëpalosjeve, filmave, si dhe mjeteve të tjera që shpjegojnë dispozitat e legjislacionit të punës dhe sugjerojnë metodat për zbatimin e tyre dhe masat parandaluese për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale;

b) udhëzimeve për shëndetin dhe sigurinë në punë.

Neni 27

Detyrimi i trupës inspektuese për paraqitjen e raporteve periodike

Zyrat vendore dhe drejtoritë rajonale detyrohen t'u paraqesin autoriteteve qendrore të inspektimit të punës raporte periodike për rezultatet e veprimtarisë së tyre.

Këto raporte hartohen sipas mënyrës së parashikuar nga struktura përgjegjëse për inspektimin e punës dhe në to trajtohen tema që diktohen, kohë pas kohe, nga ky i fundit.

Neni 28

Raporti vjetor

(ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

Struktura përgjegjëse për inspektimin e punës i paraqet ministrit përgjegjës dhe inspektorit të Përgjithshëm raportin vjetor të inspektimeve brenda datës 15 shkurt të vitit pasardhës. Ky i fundit, brenda tremujorit të parë të vitit pasardhës, ia paraqet komisionit përkatës të përhershëm parlamentar të Kuvendit..

Neni 29

Përmbajtja e raportit

(ndryshuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

Rregullat e përgjithshme për përmbajtjen e raportit dhe procesin e raportimit përcaktohen nga Inspektori i Përgjithshëm, në përputhje me ligjin për inspektimin.

KREU VI SANKSIONE DHE PROCEDURA

Neni 30

Zbulimi i shkeljeve

(shfuqizuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

Neni 31

Sanksionet

(shfuqizuar pika 2, me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013; zëvendësuar fjalë me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Trupa inspektuese e punës, për shkelje të legjislacionit të punës, vendos për njërin nga këto sanksione:

- paralajmërim, sipas ligjit për inspektimin;
- gjobë, sipas nenit 32 pika 2 dhe nenit 33 të këtij ligji;
- pezullim të punës.

2. Shfuqizuar.

Neni 32

Paralajmërimi

(ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Paralajmërimi është dënimi administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit, sipas përcaktimeve në ligjin për inspektimin. Paralajmërimi shoqërohet me një afat të caktuar për rregullimin e shkeljeve në procesverbalin e inspektimit.

2. Nëse punëdhënësi nuk ka marrë masat për zbatimin në mënyrë të plotë të dispozitave ligjore, brenda afatit të përcaktuar në aktin e inspektimit të trupës inspektuese të punës, ky i fundit vendos gjobë, sipas rasteve të përcaktuara në nenin 33 të këtij ligji.

Neni 33

Vendosja e gjobës

(shtuar pika 5 me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013; ndryshuar shkronja "b" e pikës 1, shtuar fjalë në pikën 2 dhe ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

1. Për rastet e shkeljes së legjislacionit të punës, trupa inspektuese e punës vendos gjobë si më poshtë:

a) për shkelje të dispozitave të Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, trupa inspektuese e punës vendos gjobë në masën e përcaktuar në pikat 1, 2, 3 e 5 të nenit 202 të Kodit të Punës;

b) për shkelje të dispozitave të legjislacionit të punës, përjashtuar ato të parashikuara në shkronjën "a", të pikës 1, të këtij neni, trupa inspektuese e punës vendos gjobë nga 10 deri në 50-fishin e pagës minimale, sipas parimit të proporcionalitetit, në përputhje me ligjin për inspektimin.

c) në rastet e mosnjohfimit brenda 24 orëve të aksidenteve në punë, me pasojë vdekjen, apo të aksidenteve të rënda, trupa inspektuese e punës vendos gjobë në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë.

2. Për shkelje të parashikuara në nenin 35, të këtij ligji, të përsëritura nga punëdhënësi, të konstatuara më parë nga trupa inspektuese e punës, ky i fundit vendos gjobë sa dyfishi i vlerës maksimale të parashikuar për atë lloj shkeljeje.

3. Kur trupa inspektuese e punës kundërshtohet apo pengohet në kryerjen e detyrës, subjekti sanksionohet në masën nga 10 000 deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë, në përputhje me ligjin për inspektimin.

4. Trupa inspektuese e punës, në caktimin e masës së gjobës ka parasysh përsëritjen e shkeljes, kohëzgjatjen e saj, shkallën e dëmit dhe numrin e të punësuarve të prekur nga kjo shkelje.

5. Gjoba është dënim kryesor.

Neni 34

Ankimi dhe ekzekutimi

(ndryshuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

1. Shqyrtimi, marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj vendimit të trupës inspektuese bëhen në përputhje me ligjin për inspektimin.

2. Ekzekutimi i këtyre gjobave bëhet sipas legjislacionit në fuqi për kundërvajtjet administrative.

3. Gjobat derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 35

Masa urgjente

(ndryshuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013 dhe nr. 57/2017, datë 20.4.2017)

1. Trupa inspektuese e punës vendos masën urgjente, në përputhje me ligjin për inspektimin:

a) në rastet e konstatimit të punësimit informal;

b) në rast se vazhdimi i aktivitetit përbën rrezikshmëri të menjëhershme, të rëndë, të paevitueshme për sigurinë e shëndetit e punëmarrësve dhe është i nevojshëm evakuimi i tyre nga vendi i punës.

2. Marrja e masës urgjente ose vendosja e saj si dënim plotësues bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

3. Ankimi ndaj vendosjes së masës urgjente bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin.

Neni 36

Procedura për ekzekutimin e urdhrit të pezullimit të trupës inspektuese të punës

(shfuqizuar me ligjin nr. 24/2013, datë 14.2.2013)

Neni 37

Sanksione penale

Për të gjitha shkeljet, që përbëjnë vepra penale, zbatohen dispozitat e parashikuara në Kodin Penal.

KREU VII FINANCIMI

Neni 38

Financimi

Fondet për funksionimin e strukturës përgjegjëse për inspektimin e punës sigurohen nga Buxheti i Shtetit, nga donacione të ndryshme, si dhe nga të ardhura të tjera të lejuara me ligj.

KREU VIII
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 39

Ligji nr.7986, datë 13.9.1995 “Për Inspektoratin Shtetëror të Punës”, i ndryshuar, shfuqizohet.

Neni 40

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore për zbatimin e neneve 2 pikat 19 e 20, 12 pika 2 të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare

(parashikuar me ligjin nr.24/2013, datë 14.2.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 41

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 5120, datë 20.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu